

QENDRA E
STUDIMEVE
ALBANOLOGJIKE

INSTITUTI I
GJUHËSISË DHE
I LETËRSISË

STUDIME FILOLOGJIKE

1 - 2

VITI LXVI (XLIX)

2013

QENDRA E STUDIMEVE
ALBANOLOGJIKE

INSTITUTI I GJUHËSISË
DHE I LETËRSISË

STUDIME FILOLOGJIKE

1 - 2
LXVI (XLIX)
2013
TIRANË

REDAKSIA

Prof. dr. Valter MEMISHA (kryeredaktor)

Prof. dr. Shaban SINANI (zv. kryeredaktor), prof. dr. Ludmila BUXHELI (sekretare shkencore), akad. prof. dr. Kolec TOPALLI, prof. dr. Seit MANSAKU, prof. dr. Rami MEMUSHAJ, prof. dr. Agron DURO, prof. as. dr. Anila OMARI, prof. dr. Laura SMAQI, prof. as. dr. Spiro GJONI, prof. dr. Dhurata SHEHRI, prof. as. dr. Enkeleida KAPIA.

Redaktore: Engjëllushe Karaj

Përkujdesja grafike: Dorina Muka

© Copyright: QSA, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë

Të gjitha të drejtat të rezervuara

ISSN: 0563-5780

Del dy herë në vit

Pronë letrare e Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë
të Qendrës së Studimeve Albanologjike të RSH

Adresa e redaksisë: Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë
Rruga "Naim Frashëri", nr. 7, Tiranë

PASQYRA E LËNDËS

REMZI PËRNASKA	Spiro Floqi - gjuhëtar i shquar shqiptar (1920-1983).....	5
EMIL LAË	Koncepte dhe terma të rinj të sintaksës shqipe	13
MEHMET ÇELIKU	Vendi i <i>Pyetësorit dialektologjik</i> të Spiro Floqit	
BAHRI BECI	në historinë e dialektologjisë shqiptare.....	25
LINDITË SEJDIU- RUGOVA	Pikëpamjet sintaksore të Spiro Floqit.....	35
VALTER MEMISHA	Ndihmesa e Spiro Floqit në kritikën gjuhësore	41
THOMA DHIMA	Spiro Floqi për valencën e foljeve.....	53
ENKELEIDA KAPIA	Rema dhe kontrasti në gjymtyrëzimin aktual	
	të fjalisë.....	63
TEFË TOPALLI	Çështje të rendit të fjalive në studimet	
	sintaksore të Spiro Floqit.....	73
ANILA KANANAJ	Spiro Floqi dhe minimumi i domosdoshëm	
	strukturor i fjalisë.....	89
ROZANA RUSHITI	Fjalja e varur kryefjalore sipas Spiro Floqit	101
ALBANA DEDA (NDOJA)	Togfjalëshi, sintagma dhe trajtime të tyre në	
KOLEC TOPALLI	gramatologjinë shqiptare.....	109
	Nga vepra <i>Fjalor etimologjik i gjuhës shqipe</i>	
	<i>V</i>	123
THANAS FEKA	Fjalëkrijimi si mjet poetik në veprën e	
	Lasgush Poradecit.....	143
MIMOZA KARAGJOZI- KORE	Veçori arkaike gjuhësore në të folmen e	
	qytetit të Gjirokastrës krahasuar me	
	gegërishten e <i>Mesharit</i> të Gjon Buzukut	149
SHABAN SINANI	Motivi i krijimit të rruzullimit: prej Pjetër	
	Bogdanit e Nicolò Chetta-s tek Pjetër Zarishi	
	e Atë Gjergj Fishta.....	161
EDMOND ÇALI	Vështrim variantistik romanit <i>Dasma</i> të	
	Ismail Kadarese.....	179
ERIOLA AGALLIU	Figura e femrës në përfytyrimin poetik të	
	Vedat Kokonës.....	203
	KRITIKË E BIBLIOGRAFI	
ANILA OMARI	Probleme dhe perspektiva në albanologji -	
	gjendja e studimeve në një libër të ri.....	217
EVALDA PACI	<i>Studime filologjike për letërsinë romantike</i>	
	<i>arbëreshe</i> : një arritje e re në studimet	
	albanologjike.....	221
SHABAN SINANI	Matteo Mandalà, <i>Lekë Matranga: njeriu,</i>	
	<i>koha, vepra</i> , Botimet Ombra GvG, Tiranë,	
	2013.....	225

PAVLI HAXHILLAZI

Botimi i dorëshkrimit original të veprës leksikografike trigjuhëshe italisht-greqisht-shqip të Thimi Mitkos..... 229

KOLEC TOPALLI

Anila Omari, *Marrëdhëniet gjuhësore shqiptaro-serbe*, Botimet Albanologjike, Tiranë, 2012..... 237

RAMI MEMUSHAJ

Mehmet Çeliku, *Sintaksë e gjuhës shqipe (përbërësit sintaksorë)*, ILAR, Tiranë, 2012.... 241

ANILA KANANAJ

Thoma Dhima, *Fraza me fjali të nënrenditur përcaktore-ndajshimorë të kohës*, Qendra e Studimeve Albanologjike, Tiranë, 2013..... 247

INA ARAPI

Bahri Beci & Merita Bruci, *Albanisch lernen in kurzer Zeit. Albanisch für Ausländer - Lehrbuch* (Të mësojmë shpejt gjuhën shqipe. Metodë për mësimin e gjuhës shqipe nga të huajt), EDFA, Tirana, 2011..... 253

JETA SHKENCORE

Në gjurmët e albanologjisë në Poloni (Ina Arapi)..... 259

Tryezë shkencore: *Kultura e gjuhës në mediet tona - arritje dhe probleme aktuale* (Adelina Çerpja)..... 263

Konferencë shkencore ndërkombëtare: *Kërkime gjuhësore, II*, Tiranë, 4 korrik 2013 (Engjëllushe Karaj)..... 265

EDMOND ÇALI

VËSHTRIM VARIANTISTIK ROMANIT *DASMA*
TË ISMAIL KADARESE

I. Romani "Dasma"¹ është një pjesë shumë e rëndësishme e sistemit letrar të veprës së Ismail Kadarese. Lidhet përta i përket përmbajtjes dhe përta u përket temave të trajtuara me shkrime të tjera të Kadarese si "Prilli i thyer", ku trajtohet kanuni dhe hakmarrja, dhe "Ura me tri harqe", ku trajtohet motivi i flijimit për ndërtimin e urës².

Romani "Dasma" është një roman "revolucionar" i Kadarese. Edhe pse kemi një temë "të dashur" për realizmin socialist shqiptar, luftën kundër zakoneve prapanike dhe kundër fesë, nga ana formale vepra ka një organizim të përsosur strukturor që na jep mundësi të gjera të një studimi filologjik.

Botimi i kësaj vepre ka ngjashmëri me disa vepra të tjera të kohës: bëhet fjalë për ato vepra që dalin fillimisht në revistën letrare "Nëndori" dhe pastaj si vëllim më vete (kujtojmë këtu romanin "Lumi i vdekur" të Jakov Xoxës³).

Ngjashmëria shtohet me ripunimin, me ribotimet e variantit të plotë pas variantit të shkurtuar.

Kalimi nga botimi i parë i shkurtuar në revistë në botimin e dytë si vëllim më vete është një lloj problematike; tjetër problematikë është botimi para vitit 1972 dhe botimi pas vitit 1972, domethënë, para dhe pas zhvillimit të punimeve të Kongresit të Drejtshkrimit.

Veçori e prezantimit të këtij romani nga vetë autori është fakti se Kadare e lë mënjanë sepse, shumë i njësuar me vijën e Partisë, e megjithatë e boton dhe e riboton⁴. Këtu do të paraqesim disa nga ndërhyrjet e autorit duke

¹ Ky punim është pjesë e një punimi të gjatë mbi variantistikën në romanin *Dasma* të Ismail Kadarese.

² Kujtojmë edhe tregimin *Sezoni dimëror i kafe 'Rivierës'*, ku trajtohet revolucionarizimi i jetës në luftë me mbeturinat fetare dhe me zakonet prapanike (Ismail Kadare, *Sezoni dimëror i kafe 'Rivierës'*, në "Nëndori", nr. 4, prill 1969, f. 59-82).

³ Shiko Edmond Çali, *Botimet e 'Lumit të vdekur' dhe variantet*, në Edmond Çali, "Romanet e Jakov Xoxës", Tiranë, 2003, f. 65-100.

⁴ Ismail Kadare, *Dasma*, roman, Nëndori, nr. 8, 1967, f. 3-104; Ismail Kadare, *Dasma*, Rilindja, Prishtinë, 1967, f. 146-siq lexojmë në kopertinën e pasme të librit, ky është botimi i parë i këtij romani si libër, është një rishtypje e botimit në revistë; Ismail Kadare, *Dasma*, Shtëpia Botuese "Naim Frashëri", Tiranë, 1968, f. 224; Ismail

dhënë vetëm pak shembuj. Në një punim tonin më të gjatë japim panoramën e plotë të ndërhyrjeve të autorit në botimet e ndryshme të tekstit.

Pasqyrimi i futjes së normës së gjuhës letrare në roman i jep rëndësi kësaj vepre në prozë qoftë në kuadrin e veprës së autorit, qoftë për shqyrtimin e rëndësisë së futjes dhe të mënyrës së zbatimit të normës së gjuhës letrare në veprat e botuara në Tiranë pas vitit 1972.

Shqyrtimi varianteve të autorit⁵ na jep mundësinë të shohim reflektimin e zhvillimeve gjuhësore të vepra e tij, në këtë rast edhe në një vepër të veçantë të tij. Kjo gjë merr me tepër rëndësi në këtë vepër sipas nesh sepse rëndësia e kësaj vepre është thelbësore për sa i përket formës së saj dhe strukturës së saj.

Kadare është shprehur qartë për këtë roman të tijin⁶. Në fillim thotë se premisat ishin të tjera në këtë fazë të krijimtarisë së tij:

“Si për ironi të fatit, fill pas “Përbindëshit”, në kohën që truri im ishte bërë aq naziq, sa të mos pëlqente asgjë e të kërkonte vetëm struktura të reja origjinale, në kohën, pra, që kujtoja se do të çaja shtigje të reja në art, unë shkrova “Dasmën”, veprën time më skematike dhe më pa vlerë”⁷.

Kadare, *Lëkura e daulles*, në “Gjakftohtësia”, Shtëpia botuese “Naim Frashëri”, Tiranë, 1980, f. 542, f. 361-485; Ismail Kadare, *Lëkura e daulles*, në “Vepra letrare 8”, Shtëpia botuese “Naim Frashëri”, Tiranë, 1981, f. 357, f. 243-355; edhe në këtë rast kemi një rishtypje; Ismail Kadare, *Lëkura e daulles*, në “Vepra”, vëllimi i nëntë, Shtëpia botuese Fayard, 2000, f. 574, f. 19-128; Ismail Kadare, *Lëkura e daulles*, në “Vepra. Vëllimi i katërt”, Onufri, Tiranë, 2008, f. 495, f. 357-494. Në 16 rreshtat e hyrjes para parathënies, në f. 359 kemi disa të dhëna të gabuara: aty lexojmë “Romani ‘Lëkura e daulles’ është botuar së pari me këtë titull në vitin 1967, në revistën ‘Nëntori’”; por romani në “Nëndori” del me titullin *Dasma*. Lexojmë edhe: “është ribotuar më 1981 me titullin e kahershëm ‘Lëkura e daulles’”; por romanin e gjejmë të botuar me titullin *Lëkura e daulles* qysh në përmbledhjen “Gjakftohtësia” të v. 1980. Mbi këtë roman shiko edhe: Mehmet Çeliku, *Norma gramatikore dhe shkrimtari*, në “Nëndori”, nr. 2, shkurt 1970, f. 171-187; Dalan Shapllo, *Aspekte të zhvillimit të artit tonë të realizmit socialist në dritën e mësimëve të partisë*, në “Nëndori”, nr. 12, dhjetor 1970, f. 50-66; Llazar Siliqi, *Klasa punëtore në veprat tona letrare e artistike*, në “Nëndori”, nr. 12, dhjetor 1970, f. 67-84; Dilaver Dilaveri, *Jeta e sotme revolucionare në romanin tonë*, në “Nëndori”, 1971, nr. 5, maj 1971, f. 79-88; Ali Abdihoxha, *Probleme mbi disa botime të vitit 1968*, në “Nëndori”, nr. 8, gusht 1969, f. 111-149; Éric Faye, *Parathënie*, në Ismail Kadare, “Lëkura e daulles”, “Vepra. Vëllimi i katërt”, Onufri, Tiranë, 2008, f. 361-367.

⁵ Giuseppe Gradilone për herë të parë ka botuar në Itali një punim mbi variantistikën në një vepër të realizmit socialist për poemën “Nënë Shqipëri” të Dritëro Agollit: Giuseppe Gradilone, *Il poema ‘Nënë Shqipëri’ di Dritëro Agolli* në “Studi di letteratura albanese contemporanea”, Roma, 1997, f. 59-153.

⁶ Ismail Kadare, *Ftesë në studio*, Onufri, Tiranë, 2004, f. 229, f. 74-76.

⁷ Po aty, f. 74.

Vlerësimi i autorit për veprën e tij është i prerë dhe sqarues:

“Ishte hera e parë, dhe ndoshta e fundit, që skematizmi dogmatik, me sulmin e tij të furishëm, më vuri tërësisht poshtë.”

Ishte viti 1967. Fushata antiliberale në kulturë ishte në paroksizmin e saj. Ndikimi i revolucionit kulturor kinez po bënte kërdinë. Konformizmi në letërsi, euforia, ekstaza pseudorevolucionare ishin në kulmin e tyre. Shumica e shkrimtarëve ishin dërguar për të punuar në bazë, midis punëtorëve dhe fshatarëve. Ndryshoheshin programet dhe tekstet e shkollave. Nga teatrot hiqeshin dramet e huaja. Shembeshin kishat dhe xhamitë, por sidomos kishat.

Në këtë klimë, kur shkruaja “Përbindëshin” dhe rropatjet e mia për të çelur shtigje të reja në art më dukeshin jo vetëm të një tjetër epoke, por gati monstruoze. Një brengë e madhe, në fillim e pashpjegueshme, por që qartësohej dalngadalë, po më kaplonte: brenga e ndarjes me letërsinë. Isha i bindur se po e braktisja atë, por këtë herë, ndryshe nga kriza moskovite, sëmundja ishte vdekjeprurëse.

Kjo vazhdoi për një kohë të gjatë”⁸.

Na bën përshtypje vetëdija e lartë artistike e Kadaresë:

“Ende sot nuk e kam të qartë se ç’ndodhi në thellësi të ndërgjegjes sime që, ashtu si i sëmuri që i qepet prapë jetës pas lëngatës pa shpresë, një mesditë, me dorë të pasigurt, me peshë e muzikë funebre në shpirt nisa prapë të shkruaj. Kisha pa dyshim gëzimin e ringjalljes, por ai që i mpirë, si gëzimi i njeriut, që sheh në ëndërr fytyrën e të vdekurit të dashur.

Kështu, atë vit të paharruar shkrova dhe botova romanin “Dasma”. Në fillim turbull, pastaj përherë e më qartë nisa ta kuptoja se ky roman, që unë kujtova se po më kthente në jetë, ishte në të vërtetë fillimi i vdekjes sime. Ai ishte dëshmia se unë isha thyer përpara trysnisë së skematizmit. Pa e kuptuar mirë as vetë, isha sprapsur dhe isha mposhtur. Në trurin tim diçka po shkatërrohej me ngut”⁹.

⁸ Po aty, f. 74-75.

⁹ Po aty, f. 75. Edhe reagimet pozitive të kritikës nuk e bëjnë që të ndryshojë mendim: “Kritika e priti me entuziazëm, miqtë e mi përpiqeshin të më mbushnin mendjen se nuk qe aq i keq sa ç’më dukej mua, por unë kisha filluar të ndiej përçmim për të. Isha thellësisht i brengosur. Asgjë s’mund të më detyronte të ndërroja mendim. As fakti që romani u botua në Norvegji, Suedi dhe SHBA. Një gjë e tillë s’më bëri ndonjë përshtypje, sepse ato ishin shtëpi botuese majtiste që e pëlqenin dhe e gjuanin një letërsi të tillë. Ajo që më habiti vërtet ishte mbërritja e një zarfi të trashë nga Radio-Televizioni i Londrës (BBC) me tekstin e dramatisimit të romanit tim, madje me emrat e aktorëve interpretues, si edhe me datën e dhënies. Dramatizimi kishte titullin “Dasma dhe fantazma”. Siç dukej, skematizmi po sulmonte metropolet.”, po aty, f. 75-76. Kadare e rimerr këtë temë: “-Në vitet 1967-1969, pas lirisë relative të viteve 60, unë u gjenda në mbikqyrjen e drejtpërdrejtë të regjimit, ose më saktë të vetë diktatorit.

Rreshtat e mëposhtëm shpjegojnë eliminimet e vazhdueshme në tekstin e romanit:

“Por të gjitha këto nuk ndryshuan asgjë në mëndjen time. Një ditë dimri, në studion time, më kujtohet isha me rrufë dhe i mbështjellë me shall, e mora atë nga rafti i bibliotekës dhe e vura përpara. Isha pa nerva, pa dhombshuri. Pa asgjë. Kurse ai ishte përpara meje si i dënuari që kujton se njohja ndërkombëtare do ta shpëtojë.

E preva pa mëshirë më dysh. Isha aq përbuzës, saqë nuk doja të bëja asnjë rregullim sipër tij, me përjashtim të ndonjë fraze lidhëse (si penjtë që qepin prerjet kirurgjikale). Pra e preva dhe e preva pa mëshirë derisa e përgjysmova.

Kjo vazhdoi dy orë.

Pas kësaj, si ata që përçudnojnë fytyrën e viktimës për të mos u njohur, ia ndërrova titullin, ia hoqa të drejtën të quhej roman, dhe e lashë mënjanë, me ndjesinë se, sidoqoftë, isha treguar i mëshirshëm me të. Në të vërtetë ashtu ishte: në vend që ta zhdukja fare, kisha pranuar ta operoj.

Ende sot e kujtoj atë atmosferë boshi, gjyqi të fshehtë, salle autopsie, morgu... Një kohë të gjatë kujtova se i lava duart me letërsinë. Në shpirt kisha një lloj rrënimi. As vrullet dehëse të kohës kur shkruaja “Përbindëshin”, nuk më ngjalleshin më, as skematizmi s’ më avitej dot prapë”¹⁰.

Duhet të kemi parasysh që edhe autorë të tjerë ishin brenda konformimit. Madje edhe pse vepronin me vetëdije nuk arrinin rezultatet që prisnin. Përmendim këtu rastin e romanit “Ara në mal” të shkrimtarit Petro Marko. Realizmi socialist ka ligjet e veta:

“Realizmi socialist nuk qëndron në vend, ai fiton vazhdimisht tipare të reja, por misioni i tij kryesor mbetet i pandryshueshëm: luftë për ndërtimin e botës së re me njeriun e ri në krye, i cili është gati të japë gjithçka për fitoren përfundimtare... Në qendër të letërsisë duhet të jetë “njeriu i ri”, “njeriu ynë i thjeshtë me të mirat e me dobësitë e veta, me gëzimet, shqetësimet, hidhërimet dhe entuziazmin e vet”¹¹.

Dhe çdo gjë duhet të jepet mirë artistikisht:

-Përpara meje kishte tri rrugë: e para, të konformohesha (nënvizimi është i imi, e. ç.), duke shkruar si shumica e shkrimtarëve shqiptarë, e dyta, të braktisja më në fund letërsinë, e treta, të mos konformohesha, por për këtë të paguaja një taksë.

Rrezikun e konformizimit e kuptova kur shkrova e botova romanin “Dasma” më 1967-1968. Ndonëse vepra u botua më pas në disa vende, ndonëse BBC e Londrës i bëri një radiodramatizim (“Dasma dhe fantazma”), unë aty për aty e kuptova se kjo ishte fillimi i vdekjes sime si shkrimtar, ndaj vendosa të mos bëja kurrë asnjë lëshim në letërsi”, “Dialog me Alain Bosquet”, Tiranë, Onufri, 1996, f. 189, f. 30-31.

¹⁰ Po aty, f. 76.

¹¹ Ali Abdihojha, “Probleme mbi disa botime të vitit 1968”, punim i cituar, f. 130.

“Pikërisht në trajtimin e këtij individi që punon e vepron në emër të masës, në trajtimin e kësaj mase që punon e lufton jo për të drejtat e një individi të caktuar, por të vetë masës, pjesëtar i së cilës edhe individi, letërsia jonë, me gjithë sukseset e saj është akoma prapa nga realiteti. Këtë dobësi relative që karakterizon përgjithësisht krijimtarinë tonë nuk kanë mundur ta kapërcejnë edhe disa nga veprat e rëndësishme të kohëve të fundit. Kështu Petro Marko në romanin e tij “Ara në mal” jo vetëm që nuk mundi të vendosë në qendër të ngjarjeve individin ose kolektivin që lufton për të renë dhe nga kjo platformë ideo-artistike të niste betejën kundër botës së vjetër, ...por ndodh gjithashtu që pikërisht ansambli i njerëzve tanë që luftojnë për të renë të jepet me zbetësi dhe cekësi, sidomos artistike”¹².

Përsa i përket qëndrimit të Petro Markos na vjen në ndihmë Kasëm Trebeshina. Trebeshina shumë vite me vonë (në “Fitorja në humbje. Tregim për ata që duan të dëgjojnë”, Ankara, 2001, f. 1-40, f. 27 e kopjes personale që na ka dhënë autori) citon këto fjalë që përmbledhin qëndrimin e Petro Markos: “Ti ndofta ke të drejtë, por unë nuk mund t’i mbaj dorëshkrimet në sirtar... Nuk jam si ti... Dua të botoj...”.

Por pa romanin “Dasma” nuk “kuptojmë” dot as edhe “Dimrin e vetmisë së madhe”, as “Koncertin”, as “Prillin e thyer” dhe as “Urën me tri harqe”. Kuptojmë deri në njëfarë pike refuzimin për temën e për “përmbajtjen”, por forma e tij ka shumë rëndësi në shqyrtimin e sistemit letrar të veprës së Kadarese.

Kjo vepër lidhet, pra, me “Prillin e thyer” për temën por edhe për trajtimin e personazhit. Edhe këtu, si te “Prilli i thyer”, jepet bota e brendshme e personazhit dhe jepet lidhja e tij me kanunin. Këtu i kushtohet rëndësi edhe figurës së priftit, ndikimit të fesë në jetën e atij që është në gjak. Dhe kjo jepet në kuadrin e fushatës së luftës kundër fesë në shoqërinë shqiptare të kohës.

“Dasma” lidhet edhe me motivin e flijimit të pranishëm edhe në “Ura me tri harqe”. Këtu mënyra e paraqitjes dhe e futjes në rrëfim e motivit është ndryshe por ka rëndësi dyfishe: prania e këtij motivi garanton në rrëfim, në një vepër “moderne” të Kadarese, të mitit. Nga ana tjetër vendos lidhje dhe forcon pozitat e “Dasmës” me strukturën e sistemit të veprës së përgjithshme të Kadarese ku miti ballkanik e shqiptar ka një vend shumë të rëndësishëm. Prania e specialistëve kinezë në dasëm është vetëm një paralajmërim tepër i largët i “Koncertit”. Figura e priftit (në rrëfimin e jetës së babait të Katrinës) vazhdon praninë e fesë katolike në rrëfim pas priftit tek “Gjenerali”.

Vlerësimi më i ekuilibruar dhe më i saktë deri tani, sipas nesh, është dhënë nga Shaban Sinani, një nga njohësit më të mirë të veprës së Kadarese, në

¹² Po aty, f. 130-131.

një vepër të rëndësishme të tijën, ku e likuidon me një paragraf¹³; kurse Martin Camaj në kritikën e tij të largët na jep vetëm një vlerësim sipërfaqësor për romanin¹⁴.

Na duket pak e tepruar teza e Arshi Pipës për këtë roman. Kritiku mëton që tema e romanit dhe mënyra e përdorimit të saj nga ana e autorit shërben për të dekonspiruar mesazhin tejet ideologjik të romanit. Ja çfarë shkruan Pipa:

“Fjalët e mëposhtme janë pjesë e fjalimit të sekretarit të Partisë të stacionit hekurudhor: “Duke i ngritur gratë në poste me përgjegjësi, iniciativa e të moshuarve të Lapardhasë!” Ky emër mund të lexohet si një përbërje e nyjes “La” në italishte, trajtë e shquar, femërore dhe pardha - “pordha”. Në edicionin e vitit 1980 ‘Lapardha’ është zëvendësuar me “Korça”.

Është e kuptueshme përse në zyrtaren HISTORIA E LETËRSISË SHQIPTARE E REALIZMIT SOCIALIST, që merret hollësisht me veprat e Kadaresë, nuk përmendet DASMA. Pikërisht në këtë roman Kadare fillon të farkëtojë armët e veta, të cilat ai do t’i mprehë në veprat që do të vinë më pas. Këtu ai perfeksionon mënyrën e tij të veçantë të të shkruarit: një mënyrë të shkruarit me dy kuptime, tërthortë e me analogji, shpesh alegorike dhe e theksuar nga insinuata aluzive dhe përputhje të largëta- një stil narrativ ku gjithkund gjen ironi keqdashëse të gradacioneve të ndryshme, mbështetur në mjete të tilla retorike si elipsi, hiperbola, karikatura dhe grotesku”¹⁵.

Sipas nesh largësia e Pipës nga Tirana, mungesa e kontakteve të drejtpërdrejta me botën shqiptare, mungesa e informacionit nga Tirana kulturore, mungesa e njohjes së totalitetit të zhvillimeve të brendshme politike, ekonomike e kulturore, pra vlerësimi i tyre nga një njohje tejet e kufizuar nga jashtë i bëjnë të pamundur atij (si edhe Camajt) një analizë më të plotë e më

¹³Shaban Sinani, *Kadare-një vështrim prapavajtes*, në “Për prozën e Kadaresë”, Naimi, Tiranë, 2009, f. 208, f. 90-97, f. 93.

¹⁴ Martin Camaj, *Libra të lexuem. Dasma (Roman i ri i Ismail Kadare-s)*, në “Shëjzat”, Roma, Vjeti XI-n. 9-10-11-12, Shtatuer-Dhetuer 1967, f. 469-472.

¹⁵ Arshi Pipa, *Rebeli*, në “Subversion drejt konformizmit. Fenomeni Kadare”, Tiranë, Phoenix, 1999, (Botimi i parë 1987 në revistën tremujore amerikane “Telos”, New York, 1987, përktheu Bardhyl Shehu), f. 79, f. 9-13, f. 11-12. Ja dhe një pjesë tjetër e shkrimit të A. Pipës: “Në mars të vitit 1966 Komiteti Qendror i Partisë u adresoi intelektualëve një “letër të hapur” me anën e së cilës ata ftoheshin për punë fizike në fabrika, kooperativa bujqësore, hidrocentrale, në hekurudhë dhe në objekte të tjera të ndërtimit socialist të vendit, me qëllim që shkrimtarët të njiheshin me problemet ekonomike dhe të shkruanin për to. Përgjigja e Kadaresë ishte DASMA (1967), një roman “reportazh”, ku përshkruhet jeta e një brigade vajzash që bëjnë punë vullnetare për ndërtimin e një hekurudhe diku në Shqipërinë Qendrore. Dy prej tyre përfundojnë si prostituta”, po aty, f. 10-11.

objektive. Kjo bën që edhe ndonjë vlerësim i mprehtë për letërsinë e Kadaresë të mos shoqërohet nga ndihmesa kritike më organike për autorin.

II. Botimet e librit

Kemi disa botime të librit. Pyetjes se cilin Kadare të lexojmë¹⁶ do t'i përgjigjeshim, edhe pse, sigurisht, vetëm pjesërisht, se versioni i fundit i botuar, duke presupozuar që vetë Ismail Kadare të paktën, edhe pse (nuk) merret drejtpërdrejt me ribotimin e veprës së tij, të japë mendimin për versionin (e fundit) që botohet. Kurse si studiues duhet të kemi parasysh të gjitha botimet ose rishtypjet e romanit (në këtë rast), të kemi parasysh se çfarë thotë vetë autori, ose se çfarë shkruan autori, për ta vlerësuar sa më mirë librin dhe sidomos për të dhënë një ndihmesë për të caktuar vendin e tij në sistemin letrar të veprës së Kadaresë; të vlerësojmë se si prania e këtij libri në këtë sistem e ndikon edhe për sado pak vendosjen e gjithë veprës së Kadaresë në sistemin letrar shqiptar. Vepra na ndihmon për të parë qartë vuajtjet e autorit, mundimet e tij, përpjekjet e tij, ecurinë e tij në shkrim, në krijimtari, ecurinë e tij si intelektual në fund të viteve '60 të shekullit të kaluar. Tema e luftës kundër mbeturinave fetare e kundër zakoneve prapanike, lufta për revolucionarizimin e jetës në këtë vepër të botuar gjatë realizmit socialist nuk e dëmton, përkundrazi e plotëson më mirë sistemin letrar të Kadaresë. Edhe sikur vepra të ishte shkruar e të ishte ndaluar, edhe sikur të ishte botuar vetëm një herë, kjo gjë do të kishte rëndësinë e vet. Por rëndësia e veprës shtohet më tej duke shqyrtuar ripunimin e saj. Variantet e autorit kristalizojnë dhe saktësojnë ndarjet dhe nëndarjet në sistemin e veprës së Ismail Kadaresë.

II.a. Botimi në “Nëndori”, “Dasma” (roman, variant i shkurtuar, 1967)

Romani që zë faqet e para të revistës është i ndarë në kapituj¹⁷ (shiko tabelën). Në f. 3 pas emrit të nënvizuar të autorit kemi titullin “Dasma”, pastaj

¹⁶ Për këtë shiko Elio Miracco, *Quale Kadare leggere?*, në Giuseppina Turano (a cura di, collaborazione di Alessandro Scarsella), “Kadare europeo e la cultura albanese oggi”, Atti dei seminari di studio. Venezia, 5-6 maggio 2009, f. 202, f. 17-43. Në të njëjtin botim shiko edhe Giovanni Belluscio, “NOBELESSE OBLIGE!” f. 45-78. Nga i njëjti autor shiko edhe *Leggere Kadare in italiano, tra riscritture e 'mistificazioni'*, në Alessandro Scarsella (a cura di, collaborazione scientifica di Giuseppina Turano), “Leggere Kadare. Critica Ricezione Bibliografia, Biblion Edizioni, Milano, 2007 (1° edizione, febbraio 2008), f. 187, f. 31-50.

¹⁷ Në këtë punim përdorim këto sigla dhe shkurtime: D 67 për Ismail Kadare, *Dasma, roman*, në “Nëndori”, nr. 8, 1967, f. 3-104; D 68 për Ismail Kadare, *Dasma*, Shtëpia Botonjëse “Naim Frashëri”, Tiranë, 1968, f. 224; D 80 për Ismail Kadare, *Lëkura e daulles*, në “Gjakftohësia”, Shtëpia botuese “Naim Frashëri”, Tiranë, 1980, f. 542, f.

përcaktimin “roman”. Një shënim në fund të faqes, që i referohet këtij përcaktimi, na sqaron se është një “variant i shkurtuar”. Më poshtë kemi pesë rreshta që përcaktohen si “Nga bisedat në një dasmë”: “E shikon atë lëkurë dhije të mbërthyer në listelë? Bjeri me shkop dhe mbi të do të gjëmojnë të gjitha zhurmat e jetës, që nga përkundja e djepit gjer te rropamat e lufrave.” Këtu ka shumë rëndësi fakti se na del fjala “lëkurë” dhe fjala “daulle”: janë fjalët që do të përbëjnë titullin e botimit të vitit 1980 (në këtë botim ky është titulli i kap. 21). Kapitujt janë të pajisur me titull. Titulli i kapitullit është i shkruar me shkronja të mëdha.

II.b. Botimi në vëllim “Dasma” (roman, 1968)

Romani “Dasma” botohet si vëllim më vete nga shtëpia botuese “Naim Frashëri” në vitin 1968. Në f. 224, që është faqja e fundit e librit, kemi saktësimin e vitit të mbarimit, 1967.

Në f. 3 gjejmë përsëri pesë rreshtat e hyrjes si në D 67. Fillimi i romanit, që në D 67, zë f. 3, këtu jepet me shkrim të pjerrët dhe zë f. 5 dhe 6. Edhe në këtë botim, si në D 67, kapitujt janë të pajisur me titull. Titulli i kap. është me shkronja të mëdha me shkrim të pjerrët. Përveç kësaj, çdo fillim kapitulli ka faqe të re, dhe jo në vijim, si tek “Nëndori”, ku imagjinojmë, që vazhdimi i kapitullit vijues në faqen ku mbaron i mëparshmi rrjedh nga nevoja e kursimit të vendit. Titujt e kapitujve nuk ndryshojnë, (me përjashtim të titullit të kapitullit 22).

Meqë varianti i botimit të parë është një variant i shkurtuar i romanit, në botimin D 68 kemi shumë shtesa. Përmendim këtu vetëm disa shtesa. Japim nr. e f. të D 68 dhe në kllapa nr. e f. të D 67.

Në kap. 2, “Baraka prej pupuliti”, në f. 26-27 (14) shtohen 8 rreshta. Shtesa ka rëndësi sepse na përshkruan një personazh, motrën e vogël të Xhevitit. Në D 67 nuk e kishim hasur këtë personazh. Vajza dymbëdhjetëvjeçare është e ulur në tavolinën kryesore midis babait të Katrinës dhe drejtorit.

Në kap. 3, “Nepërka”, në f. 33 (17) shtohen 4 rreshta. Jemi në kapitullin ku zëri i autorit na përshkruan pothuajse një fazë të tërë të jetës së babait të Katrinës. Shtesa e përshkrimit ka rëndësi sepse vazhdon një ndryshim në rrëfim. Në D 67 kufoma e të vrarit është vendosur në një arkivol, kurse në D 68 mbi një rrasë të rëndë guri (D 68, 33 duke mbajtur në krahë rrasën e rëndë të gurit, ku qe shtrirë kufoma, shkuan ngadalë në vorrezat) D 67, 17 Pastaj,

361-485; D 2000 për Ismail Kadare, *Lëkura e daulles*, në “Vepra”, vëllimi i nëntë, Shtëpia botuese Fayard, 2000, f. 574, f. 19-128; D 2008 për Ismail Kadare, *Lëkura e daulles*, në Vepra, Vëllimi i katërt, Onufri, Tiranë, 2008, f. 495, f. 357-494; kap.=kapitull, f.=faqja; f.=faqet. Referimet bibliografike i japim të plota në shënimet në fund të faqes.

duke mbajtur arkivolin mbi krahë, shkuan në varrezat) (shiko tabelën). Pra në D 68 shtesa është më se e motivuar dhe vijon në përshkrimin e funeralit duke përfshirë edhe ndryshimin e futur në tekst që më parë: “Rrasa e gurtë ishte bërë një me kufomën e kallkanosur. Ata lëmonin tokën e ashpërsuar nga ngrica dhe i luteshin që të mos ta nxirrte përjashta vëllanë e tyre në këto net të zeza dimri.

Po në këtë kap., në f. 35 (18) shtohen 20 rreshta¹⁸.

Ndryshimet gjuhësore janë shumë të rëndësishme¹⁹. Nga shembujt në vijim shohim se autori i bën ato për konformimin e tekstit, për të arritur një

¹⁸ Përmendim vetëm disa nga shtesat:

Përsëri në kap. 3, në f. 36 (18), shtohen 23 rreshta, në f. 37 (18), shtohen 6 rreshta.

Në kap. 4, *O montator, o zog shtegëtar*, në f. 43 (21) shtohen 13 rreshta; në f. 44 (21), shtohen 9 rreshta; përsëri në f. 44 (22) shtohen gjithsej 11 rreshta; në f. 49 (24) shtohen 20 rreshta. Në kapitullin 5. Xheviti, f. 52 (25), shtohen 13 rreshta. Shtesa në një kapitull si ky, ku rrëfimi ndryshon këndvështrim dhe vazhdon në vetë të parë me anë të monologut të brendshëm të njërit prej personazheve kryesore të librit ka shumë rëndësi për vetë strukturën e romanit. Për këtë temë përmendim vetëm: Angelo Marchese, *Il punto di vista narrativo*, në “L’officina del racconto”, Milano, Mondadori, 1997, f. 92-97; Angelo Marchese, “punto di vista”, në “Dizionario di retorica e di stilistica”, Milano, Mondadori, 1991, f. 253-254; Roland Bourneuf- Réal Ouellet, *Il punto di vista*, në “L’universo del romanzo”, Torino, Einaudi, 1976, f. 72-93; Robert Scholes - Robert Kellogg, *Il punto di vista nella narrativa*, në “La natura della narrativa”, Il Mulino, Bologna, 1970, f. 305-359; David Lodge, *Il punto di vista*, në “L’arte della narrativa”, Bompiani, Milano, 2001, f. 36-41; Gérard Genette, *Prospettiva, Focalizzazioni, Alterazioni, Polimodalità*, në “Figure III, Discordo del racconto”, Einaudi, Torino, 1976, f. 233-258; si edhe Seymour Chatman, *Storia e discorso. La struttura narrativa nel romanzo e nel film*, Pratiche Editrice, Parma, 1981, f. 325; Gruppo µ, *Il punto di vista*, në “Retorica generale. Le figure della comunicazione”, Bompiani, Milano, 1976, f. 289-293; Maria Corti, *Il punto di vista deformante*, në “Il viaggio testuale”, Einaudi, Torino, 1978, f. 135-147; Earl Miner, *Punti di vista e di attenzione*, në “Poetiche della creatività. Un saggio interculturale sulle teorie della letteratura”, Armando Editore, Roma, 1999, f. 352, f. 255-296, (botimi origjinal: Earl Miner, *Comparative poetics. An Intercultural Essay on Theories of Literature*, Princeton University, Princeton, New Jersey, 1990, f. 259); Cesare Segre, *Il punto di vista, Narratologia e punto di vista, Plurivocità e punto di vista*, në “Avviamento all’analisi del testo letterario”, Einaudi, Torino, 1985, f. 23-28, f. 124, f. 128-131, f. 405; Wayne C. Booth, “Retorica della narrativa”, La nuova Italia Editrice, Scandicci (Firenze), 1996, f. 557.

Në kapitullin 7, Kujtimi i një ankthi në f. 67 (22) shtohen 22 rreshta.

¹⁹ Vetëm përmendim këtu ndryshimet në shkrimin e ndajfoljes: 23, 25, 31, 64 në qoftë se] nëqoftëse 12, 13, 16, 31; 30 padashur] pa dashur 15; ndryshimet në përdorimin e ë-së tek mbiemri: 9 për qytetin e ardhshëm] për qytetin e ardhëshëm 5; 9 orarin e përkohshëm] orarin e përkohëshëm 5; 14, 22 e jashtme] e jashtëme 7, 11. Nga ndryshimet fonetike përmendim zëvendësimin e bashkëtingëllores afrikate qiellzore-

përsosje stilistike dhe për të respektuar normën gjuhësore. Ato ndihmojnë për të kuptuar stilin e autorit por njëkohësisht edhe zhvillimet në gjuhën letrare shqipe.

Veçojmë këtu përdorimin e trajtave të shkurtra të përemrit vector²⁰ dhe ndryshimet në përdorimin e emrit²¹.

Il.c. Botimi në “Gjakftohtësia” (“Lëkura e daulles”, në “Gjakftohtësia” novela, 1980)

Në vëllimin me novela “Gjakftohtësia” vepra na del me titullin “Lëkura e daulles”.

Fillon me thënien në f. 363 (Nga biseda në një dasinë) dhe me hyrjen më shkrim të pjerrët (f. 363-364). Në këtë botim kapitujt në vijim nuk janë të pajisur me titull por vetëm më numër që tregohet me shifër romake.

Në kalimin nga D 67 në D 68 mbizotëronin shtesat, meqë kalohej nga një botim i shkurtuar në revistë në një botim të plotë në vëllim, kurse në kalimin nga D 68 në D 80 mbizotërojnë eliminimet.

alveolare të pazëshme ç me bashkëtingëlloren fërkimore qiellzore-alveolare të pazëshme sh: 71 të shkujdesur] të çkujdesur 35; 9 u shfaq] u çfaq 5; 9 ishin shfaqur] ishin çfaqur 5. Një tjetër ndryshim është eliminimi i përdorimit të apostrofit në kushtoren e foljes: 8 do të ishte] do t'ishite 4; 61 unë do të isha] unë do t'isha 30.

²⁰ Në të gjitha çiftet e shembujve që rendisim në vijim forma e parë para kllapës katrore është ajo e D 68 e paraprirë nga numri i faqes, kurse forma e dytë, ajo pas kllapës katrore është forma e D 67, e pasuar nga numri i faqes: A) D 68, 34 kur ja jepnin dorën] kur i a jepnin dorën D 67, 17; Kemi lëkundjen e autorit, kalimin nga një formë jo e normës tek një formë tjetër, përsëri edhe kjo jo e normës. B) Po kemi edhe kalimin nga një formë e normës në një formë jo të normës: 71 nuk ja arritën dot qëllimit] nuk ia arritën dot qëllimit 34; C) Kemi mbetjen tek e njëjta formë jo e normës: 59 inspektori ja përsëriti] Inspektori ja përsëriti 28; D) kemi mbetjen tek e njëjta formë e normës: 29 atij iu kujtua] atij iu kujtua 29; E) kemi kalimin nga një formë jo e normës në një formë të normës: 37 atij iu ngroh zemra] atij ju ngroh zemra 18.

²¹ Përsa u përket ndryshimeve që pëson emri. Kujtojmë se ndryshon edhe emri i përveçëm i një personazhi dytësor: 45-46 Lulzim Rama] Sulua 22. Përsa i përket numrit të emrit përmendim se ndryshimi: 34 ishte vjeshtë] ishte pranverë 17. Në kapitullin e tretë ka rëndësi për vetë kohën e ngjarjes së rrëfyer. Kemi ndryshime me futjen e fjalëve sinonime: 34 me qetë] me buajt 17. Kemi kalimin nga numri shumës në numrin njëjës: 31 në horizontin e pafund] në horizontet e pa fund 16. Kemi lëkundje në përdorimin e formës së shumësit të emrit: 29 e disa dyfeqeve] e disa dyfegjeve 15. Kemi kalimin në formën e normës të shumësit: 34 me këto ditë] me këto ditë 17. Ka shumë rëndësi përputhja e gjinisë së mbiemrit me gjininë e emrit në numrin shumës. Kemi kalim nga një formë e normës në një formë jo të normës: 36 librat e trasha] librat e trashë 18; kemi mbetjen në një formë jo të normës: 10 hodhi hapat e para] hodhi hapat e para 5; por kemi edhe kalimin nga një formë jo e normës në një formë të normës: 23 në reportazhet tuaja të thata] në reportazhet tuaj të thatë 12.

Eliminimet në kalimin nga D 68 në D 80 janë të shumta: janë rreshta, pjesë faqesh, faqe të tëra, pjesë kapitujsh dhe kapituj. Kështu kalojmë nga 23 në 20 kapituj²². Shkurtohen edhe tre rreshta të hyrjes së romanit (shiko tabelën).

Por njafton edhe një shtesë fare e shkurtër 424 (118): “Ai i afroi kokën dhe e puthi në buzë. Vajza nuk kundërshtoi”, për të pasur një zhvillim më të plotë të rrëfimit në roman.

Autori është i kujdesshëm në “ruajtjen” e rrëfimit. Kështu paraprin një pyetje në bisedë përsa i përket emrit të përveçëm të vajzës. Kemi një transpozicion: 408 Më falni, si ju quajnë?| Si ju quajnë 73. Autori e zhvendos pyetjen, e paraprin këtë informacion në bisedë për emrin duke e marrë kështu nga pjesa e eliminuar tërësisht në D 80 tek f. 408.

Përsa u përket ndryshimeve gjuhësore në kalimin nga D 68 në D 80 kemi një uniformim të plotë me standardin gjuhësor.

A) Kështu veprohet me trajtat e shkurtra të përemrit vetor:

389 ia kishin marrë këngës| ja kishin marrë këngës 40

391 po t'ia mbanim mend emrin| po t'ja mbanim mend emrin 43

400 ia përsëriti| ja përsëriti 59

404, 433 ia bëri me dorë| ja bëri me dorë 64, 114

404 ia bëri gazetari| ja bëri gazetari 64

407 ata nuk ia arritën dot qëllimit| ata nuk ja arritën dot qëllimit 71

434 po u thoshte shokëve| po iu thoshte shokëve 146

445 a ia pe fytyrën| a ja pe fytyrën 166

B) Kemi kalimin përfundimisht në formën e normës të përdorimit të përemrit “njëra”:

400 pyeti njëra nga vajzat| pyeti njera nga vajzat 59

C) kemi ndryshimin në përdorimin e emrave.

393 së vallëzuesve| së vallëzonjësve 47

²² Ja një pjesë e eliminimeve në kalimin nga D 68 në D 80. Japim nr. e f. të D 80, nr. f. të D 68 në kllapa dhe nr. e rreshtave të eliminuar: 370 (12-13) 24 rr., 371 (15) 13 rr., 372 (16) 10 rr., 372 (17) 30 rr., 372 (18) 2 rr., 393 (45+45) 22 rr., eliminohet kapitulli “Xheviti”, f. 51-53 i D 68; 397 (54) 9 rr., 397 (55) 20 rr., 399 (57) 17 rr., 405 (65) 27 rr., 406 (67-70) 73 rr., 409 (73-75) 50 rr., 409 (76-88) 380 rr., 413 (94) 18 rr., 414 (94-96) 39 rr., 418 (101-105) 117 rr., 419 (106) 4 rr., 420 (107) 6 rr., 420 (108-109) 31 rr., 422 (111) 6 rr., 422 (112-115) 97 rr., 424 (117) 1 rr., 432 (131-143) eliminohet i tërë kapitulli 12. “Xheviti” i D 68; 435 (146) 3 rr., 435 (147) 21 rr., 436 (148-150) 48 rr., 437 (151) 3 rr., 437 (152-158) 179 rr., këtu eliminohen shumë të dhëna për personazhin e Rudil, që kështu mbetet i cinguar në D 80; 447 (168-169) 36 rr., 447 (170-173) 93 rr., eliminohet biseda S. K.-Dhori në kapitullin 16. “Kërkohej një njeri me lungë” të D 68, etj.

D) Kemi ndryshim në emrin e personazhit: Shkrimtari S. K. bëhet në D 80 shkrimtari i ri D. D.

E) Kemi edhe ndryshim në përcaktimin e personazheve të tjera:

372, 393 Të ftuarit e Shkodrës] Azoteci 18, 45

372 Të ftuarit e Shkodrës] montatorët e Azotecit 18

Il.d. Ndryshime gjuhësore që ndikojnë drejtpërsëdrejti në ecurinë e rrëfimit: Kadare mbetet pa gjakës. Ndoshta.

Romani del në vitin 2000 me titullin “Lëkura e daulles” në vëllimin e nëntë të veprave të Kadaresë të botuara nga shtëpia botuese Payard. Edhe në këtë botim libri ka njëzet kapituj të pajisur me numra. Kemi ndryshime edhe në introduktin e veprës (shiko tabelën): D 80, 363 në listelë] në dru, D 2000, 31. Ndryshimet vazhdojnë edhe tek hyrja: D 80, 363 treni i pasagjerëve] treni i udhëtarëve D 2000, 23; 364 duke montuar me shpejtësi shinën] duke mbërthyer me ngut shinën 23; 364 Inspektorët] Mbikqyrësit 23; 364 të çmontonin shinat] të zbërthenin shinat 24. Në këtë punim **ndërhyrjet e autorit janë eliminime** si në f. 37 (378), 3 rreshta, në f. 49 (391), 7 rreshta; 54 (398), 7 rreshta, që ndikojnë në shkurtimin e dialogut duke e bërë rrëfimin më të rrjedhshëm. **Kemi edhe pak shtesa** si në f. 60 (403) ku vendin e mbiemrit “qesharake” e zënë 3 rreshta. Kështu “një dasmë qesharake” bëhet: “një dasmë në të cilën djaloshi i lënë prej nuses, për shkak të fejesës me një tjetër, e kishte spërkatur shtëpinë e vajzës me ujërat e zeza, që bartte me makinën e vet”. Por ajo që **mbizotëron** është **ndryshimi i disa termave me fjalë sinonime**, ndryshim që bëhet më futjen e një fjale të shqipes për zëvendësimin e fjalës së huaj. (Për këtë shiko tabelën për përdorimin e fjalës “konduktor”). Kjo lloj ndërhyrjeje e autorit dëshmon një prirje në punën e tij krijuese.

Por në D 2000 veçojmë ndryshimin e bërë me zëvendësimin e fjalës “grurë” me fjalën “misër”. (Për këtë shiko tabelën)

Gjatë tregimit brenda tregimit, gjatë rrëfimit të jetës së babait të nuses nëpërmjet rikthimit prapa në kujtesë me përsëritjen e flukseve të mendimeve për dasmën e tij dhe për rënien në gjak të familjes së tij ndryshimi i termit ka shumë rëndësi. Vetëm në këtë botim kemi termin “misër”, gjë që na krijon jo pak pasiguri në ecurinë rrëfimore. Personazhi kujton se si kishte mbjellë një arë me misër dhe se në misër është kur vret hasmin. Në rrëfim kemi mospërputhje që ndikojnë në kuptimin e tekstit dhe që vetëm me anë të varianteve të botimeve të tjera, ku na del vetëm fjala “grurë”, mund t’i justifikojmë. Kemi këtu një rast shumë të qartë ndryshimi leksikor pa përputhjen, përshtatjen, adeguimin me kontekstin logjik dhe semantik. Kemi në këtë rast edhe një provë të një orvatjeje të dështuar të autorit që ta rifusë tekstin në sistemin e tij letrar, por jo si vepër të realizmit socialist. Për këtë na ndihmon rëndësia e grurit, e kallëzave të grurit kaq shumë të pranishme

në simbologjinë socialiste, si simbol i punës, i begatisë, i afrimit të fshatarësisë me klasën punëtore. Vetë rikthimi nga termi “misër” që do ta nxirrte jashtë realizmit socialist veprën, duke i hequr asaj një element shumë të rëndësishëm simbolik, në termin “grurë” në botimin e D 2008, e rifut sërish romanin brenda rrymës letrare të Shqipërisë socialiste.

II.e.Vazhdim për botimin e fundit

Botimi i romanit me titullin “Lëkura e daulles” në vëllimin e katërt të veprave të Ismail Kadaresë të botuara nga shtëpia botuese “Onufri” plotëson panoramën tonë të botimeve të kësaj vepre. Edhe në këtë botim autori vazhdon të ripunojë tekstin e tij. Një pjesë e varianteve të autorit në këtë botim hyjnë në vazhden e ripunimit të vetë veprës, kurse një pjesë tjetër kanë të bëjnë me një tipar të shkrimit të Kadaresë të kësaj periudhe: me kujdesin a lartë për rregullimin e gjuhës së tekstit të vet letrar. Veçojmë këtu kujdesin e veçantë për pastrimin e gjuhës nga çdo term që autorit i duket si fjalë e huaj ose jo e përshtatshme për rrëfimin si edhe saktësinë pothuajse të përsosur në përdorimin e shenjave të pikësimit, sidomos të presjes.

III. Ndoshta ky roman është shembulli i skajshëm dhe tregues i qëndrimit të autorit ndaj pjesës së veprës së tij që sot ai vetë do të përjashtojë nga sistemi i veprës së tij letrare. Mendojmë se kjo vepër, ashtu si pjesë të veprave të tjera që eliminohen në ribotimet e fundit kanë vendin e tyre të pazëvendësueshëm në sistemin e veprës letrare të Ismail Kadaresë, vepër e cila, për një pjesë të mirë të saj u krijua, u botua, u lexua, por edhe u përjashtua dhe u dënua në Shqipëri dhe jashtë vendit gjatë realizmit socialist²³. Megjithatë duhet ta pranojmë këtë rivendosje të veprave në sistem, këtë ndryshim në vetë strukturën e sistemit sepse çdo ndryshim i autorit në veprën e tij është pjesë e mozaikut të veprës së tij letrare.

Me gjithë praninë e tërë këtyre varianteve të autorit nuk mund të pohojmë për këtë roman atë çka Elio Miracco, shkencërisht, thekson për romanin “Kështjella”: “Il romanzo si trasforma per gli interventi nel contenuto

²³ Për këtë shiko Edmond Çali, *Ismail Kadare e il dissenso nel realismo socialista albanese*, në Tiziana D’Amico (a cura di), “A vent’anni dalla caduta del muro di Berlino”, Napoli, 2011, f. 13-27. Por edhe Edmond Çali, *Kryevepra e Kadaresë*, në “Jeta e re”, Prishtinë, nr. 2, 2011, f. 334-362; Edmond Çali, *Disidencë e Kasëm Trebeshinës dhe e Ismail Kadaresë ndaj realizmit socialist*, në “Studime albanologjike”, Tiranë, 2010/2, f. 210-222; Edmond Çali, “*The Winter of the Great Solitude*” by Ismail Kadare - *Test of Dissidence against Communism and Socialist Realism* në “International Journal of Science”, volume 2, 2012, f. 82-94; Edmond Çali, *Ismail Kadare: “The Winter of Great Solitude” - as a Proof of Dissent against Communism and Socialist Realism*, në “International Journal of Science”, volume IV, 2013, f. 225-241.

che "rivoluzionano" il messaggio per il lettori odierni. Il Nostro, con la sua riscrittura, libera il testo dal contesto ideologico e politico della sua genesi"²⁴. Dhe kjo sepse këtë përpunim për "Dasmën" Kadare e kishte nisur ta bënte që gjatë periudhës së realizmit socialist. Duke ndjekur analizën e historisë së tekstit të "Dasmës" citojmë M. Mandalà-në që shkruan për "Kështjellën", por për botimet para vitit 1990:

"Për shkak të një bashkëpranije të tillë të risisë dhe të braktisjes tek "Rrethimi", do të marrim në shqyrtim tekstin e botimit të parë të romanit, atë që mban titullin "Kështjella", dhe jo botimet e ripunuara pas vitit 1990. Megjithëse këto të fundit përmbajnë argumente dhe dëshmi më të qarta në mbështetje të interpretimit tonë, botimi i vitit 1970 është, pa dyshim, më i përshtatshmi për të nxjerrë në pah tiparet kryesore të poetikës kadareane në një periudhë vendimtare të zhvillimit të saj"²⁵.

Pyetjes se cili është botimi që autori e konsideron si botimin përfundimtar të kësaj vepre do t'i përgjigjeshim duke thënë se është D 2008.

Pyetjes se a na mjafton ky botim për të kuptuar mesazhin që kjo vepër na jep në kuadrin e sistemit letrar të Kadaresë, do t'i përgjigjeshim duke thënë se na e garanton këtë vetëm pjesërisht, dhe se vetëm shqyrtimi i varianteve të autorit na e plotëson, ndoshta, këtë mesazh.

Siç paraqesim shkurt në këtë punim botimet e romanit kanë dallime midis tyre. Saktësojmë shkurt se botimi i parë (D 67), botimi i dytë (D 68) dhe botimi i tretë (D 80) janë bërë në kohën e realizmit socialist, pra edhe në kohën e censurës, të autocensurës, në kohën e mungesës së lirisë së të shkruarit.

Botimi i parë ka dallime strukturore me botimet e tjera. Është një variant i shkurtuar. Botohet në revistën "Nëndori". Ka titullin "Dasma", ashtu si edhe botimi i dytë, botim më vete në vëllim. Tek D 67 dhe tek D 68 kemi të njëjtin numër kapitujsh, 23, por në D 68 kemi shumë shtesa dhe pak fare eliminime. Në dy botimet e para kapitujt janë të pajisur me tituj. Kurse në tri botimet e tjera, përveç dallimit strukturor që ka të bëjë më numrin e kapitujve, në D 1980, D 2000 dhe D 2008 kapitujt janë 20, mungojnë edhe titujt e kapitujve, kapituj që janë të pajisur me numra me shifra romake. Këto dallime strukturore janë të lidhura edhe me dallimet përmbajtësore midis botimeve. Eliminimi në D 80, D 2000 dhe në D 2008 i tre kapitujve "Xheviti" (1) dhe "Xheviti" (2) dhe "Katrina" (1) na reduktojnë informacionin në rrëfim. Dhe kjo theksohet sidomos po të kemi parasysh që në të tre këta kapituj autori përdor teknikën e këndvështrimit të ngjarjes nga dy nga personazhet e tij dhe

²⁴ Elio Miracco, *Analisi di temi del romanzo "Kështjella" di Ismail Kadare*, Roma 2007, f. 85, f. 73.

²⁵ Matteo Mandalà, *Kështjella e letërsisë dhe themelet e poetikës kadareane*, në Ismail Kadare, "Vepra", vëllimi i tretë, Tiranë, Onufri, 2008, f. 382, f. 9-29, f. 10.

me anë të monologut të brendshëm. Informacioni për personazhin në veçanti por edhe për linjën rrëfimore kryesore privohet nga dy këndvështrime të protagonistëve të veprës. Njëkohësisht ndryshimi i strukturës së përgjithshme të romanit, me anë të reduktimit të sasisë, të gjatësisë së tekstit kushtëzon vetë qenësinë e tekstit letrar si tërësi. **Përsa u përket dallimeve gjuhësore.** Në botimin e parë D 67 dhe në botimin e dytë D 68 kemi lëkundje të autorit dhe ndryshimin në përdorimin e formave gjuhësore. **Dallimet gjuhësore janë të theksuara midis D 68 dhe D 80,** gjë që i detyrohet normës gjuhësore në fuqi në Shqipëri pas vitit 1972. Edhe në dy botimet e fundit konstatojmë një punë të vazhdueshme të autorit me gjuhën, me shtesa, shkurtime, zëvendësime fjalësh. Është një punë e pashtershme e Kadarese për të bërë të mundur arritjen e konformimit të tekstit sipas shijes artistike të lexuesit të sotëm të veprës së tij duke e ndryshuar dhe duke e përsosur tekstin.

Tabela n. 1/Titulli

D 67	D 68	D 80	D 2000	D 2008
Dasma	Dasma	Lëkura e daulles	Lëkura e daulles	Lëkura e daulles

Tabela n. 2/Numrat e kapitujve

D 67	D 68	D 80	D 2000	D 2008
23 kapituj të pajisur me titull	23 kapituj të pajisur me titull	20 kapituj të pajisur me numër me shifër romake	20 kapituj të pajisur me numër me shifër romake	20 kapituj të pajisur me numër me shifër romake
Një stacion pa emër, f. 4-6	Një stacion pa emër, f. 7-11	I, f. 365-368	I, f. 25-28	I, f. 373-377
Baraka prej pupuliti, f. 6-14	Baraka prej pupuliti, f. 12-27	II, f. 369-378	II, f. 28-38	II, f. 377-388
Nepërka, f. 14-19	Nepërka, f. 28-39	III, f. 379-388	III, f. 38-47	III, f. 389-399
O montator, o zog shtegëtar..., f. 19-24	O montator, o zog shtegëtar..., f. 40-50	IV, f. 389-396	IV, f. 47-54	IV, f. 399-407
Xheviti, f. 24-25	Xheviti, f. 51-53			
Në trenin e	Në trenin e	V, f. 397-403	V, f. 54-	V, f. 408-415

orës 20 e 40', f. 25-31	orës 20 e 40', f. 54-63		60	
Kujtimi i një ankthi, f. 31-36	Kujtimi i një ankthi, f. 64-75	VI, f. 404-409	VI, f. 60-65	VI, f. 415-421
Katrina, f. 37-42	Katrina, f. 76-88			
Në trenin e fundit, f. 42-47	Në trenin e fundit, f. 89-100	VII, f. 410-417	VII, f. 65-72	VII, f. 421-428
Nata e betonimit dhe nata e Bartolomeut, f. 47-57	Nata e betonimit dhe nata e Bartolomeut, f. 101-119	VIII, f. 418-426	VIII, f. 72-79	VIII, f. 429-438
Natën e mirë, xha Shurko!, f. 57-62	Natën e mirë, xha Shurko!, f. 120-130	IX, f. 427-432	IX, f. 80-85	IX, f. 438-444
Xheviti, f. 62-68	Xheviti, f. 131-143			
Dasma vazhdon, f. 68-75	Dasma vazhdon, f. 144-160	X, f. 433-439	X, f. 85-91	X, f. 444-451
Pranvera, f. 75-76	Pranvera, f. 161-162	XI, f. 440-441	XI, f. 91-92	XI, f. 452
Katrina, f. 76	Katrina, f. 163-164	XII, f. 442-443	XII, f. 92-93	XII, f. 453-454
Kërkohet një njeri me lungë, f. 77-80	Kërkohet një njeri me lungë, f. 165-174	XIII, f. 444-448	XIII, f. 93-97	XIII, f. 454-458
Ato që janë përrjashta, f. 80-85	Ato që janë përrjashta, f. 175-183	XIV, f. 449-455	XIV, f. 97-104	XIV, f. 459-466
Pasagjeri i natës, f. 85-87	Pasagjeri i natës, f. 184-189	XV, f. 456-460	XV, f. 104-107	XV, f. 466-470
Legjenda kërkon të drejtat e	Legjenda kërkon të drejtat e	XVI, f. 461-68	XVI, f. 108-114	XVI, f. 471-478

saj, f. 88-93	saj, f. 190-200			
20.Katrina, f. 93-97	Katrina, f. 201-208	XVII, f. 469-473	XVII, f. 114-118	XVII, f. 479-483
Lëkura e daulles, f. 97-102	Lëkura e daulles, f. 209-217	XVIII, f. 474-478	XVIII, f. 119-123	XVIII, f. 484-488
<u>Njeriu</u> i <u>natës</u> , f. 102- 103	<u>Njerëzit</u> i <u>natës</u> , f. 218-219	XIX, f. 479-480	XIX, f. 123-124	XIX, f. 488-490
Në mëngjes, f. 103-104	Në mëngjes, f. 220-224	XX, f. 481-485	XX, f. 124-128	XX, f. 490-494

Tabela n. 3/Introdukti

D 67	D 68	D 80	D 2000	D 2008
E shikon atë lëkurë dhije të mbërthyer në listelë? Bjeri me shkop dhe mbi të do të gjëmojnë të gjitha zhurmat e jetës, që nga përkundja e djepit gjer te rropamat e luftrave. (Nga bisedat në një dasmë) (f. 3)	E shikon atë lëkurë <u>dhije</u> të mbërthyer në listelë? Bjeri me shkop dhe mbi të do të gjëmojnë të gjitha zhurmat e jetës, që nga <u>përkundja</u> e <u>djepit gjer te rropamat</u> e <u>luftrave</u> . (Nga bisedat në një dasmë) (f. 3)	E shikon atë lëkurë <u>dhie</u> të mbërthyer në <u>listelë</u> ? Bjeri me shkop dhe mbi të do të gjëmojnë të gjitha zhurmat e jetës. (Nga <u>bisedat</u> në një dasmë) (f. 393)	-E <u>shikon</u> atë lëkurë dhie të mbërthyer në <u>dru</u> ? Bjeri me shkop dhe mbi të do të gjëmojnë të gjitha zhurmat e jetës. (Nga <u>biseda</u> në një dasmë) (f. 21)	-E <u>shihni</u> atë lëkurë dhie të mbërthyer në dru? Bjeri me shkop dhe mbi të do të gjëmojnë të gjitha zhurmat e je-tës. (Nga biseda në një dasmë) (f. 369)

Tabela n.4 /arkivol-rrasë guri

D67/Nepërka	D 68/Nepërka	D 80/kap. III	D 2000/kap. III	D2008/kap. III
1)... <u>arkivolin e madh të vëllait të tij e vendosën në mes të dhomës së madhe.</u> (f. 17)	1)... <u>trupin e madh të vëllait të tij e vendosën në mes të dhomës së madhe mbi një rrasë guri.</u> (f. 32)	1)... <u>trupin e madh të vëllait të tij e vendosën në mes të dhomës së madhe mbi një rrasë guri.</u> (f. 382)	1)... <u>trupin e madh të vëllait të tij e vendosën në mes të dhomës së madhe mbi një rrasë guri.</u> (f. 41)	1)... <u>trupin e madh të vëllait të tij e vendosën në mes të dhomës së madhe, mbi një rrasë guri.</u> (f. 393)
2)... <u>ndërsa arkivoli ishte i lartë, i madh the i zi, i bërë nga dru i rëndë lisi.</u> (f. 17)				
3) <u>Pastaj, duke mbajtur arkivolin mbi krahë, shkuan në varrezat...</u> (f. 17)	3) <u>Pastaj, duke mbajtur mbi krahë rrasën e rëndë të gurit, ku qe shtrirë kufoma, shkuan ngadalë në vorrezat...</u> (f. 33)	3) <u>Pastaj, duke mbajtur mbi krahë rrasën e rëndë të gurit, ku qe shtrirë kufoma, shkuan ngadalë në varreza...</u> (f. 383)	3) <u>Pastaj, duke mbajtur mbi krahë rrasën e rëndë të gurit, ku qe shtrirë kufoma, shkuan ngadalë në varreza...</u> (f. 42)	3) <u>Pastaj, duke mbajtur mbi krahë rrasën e rëndë të gurit ku qe shtrirë kufoma, shkuan ngadalë në varreza...</u> (f. 393)
	4) <u>Rrasa e gurtë ishte bërë një me kufomën e kallkanosur</u> (f. 33)	4) <u>Rrasa e gurtë ishte bërë një me kufomën e kallkanosur</u> (f. 383)	4) <u>Rrasa e gurtë ishte bërë një me kufomën e ngrirë si qelq.</u> (f. 42)	4) <u>Rrasa e gurtë ishte bërë një me kufomën e ngrirë si qelq.</u> (f. 393)

Tabela 5 /konduktor

D 67	D 68	D 80	D 2000	D 2008
Dhe hyri konduktori i vagonit (f. 29)	Dhe hyri konduktori i vagonit (f. 60)	Dhe hyri konduktori i vagonit (f. 400)	Dhe hyri një mbikqyrës treni (f. 57)	Dhe hyri një mbikëqyrës treni. (f. 411)
U përgjegj konduktori (f. 29)	U përgjegj konduktori (f. 60)	-u përgjigj konduktori (f. 401)	-u përgjigj mbikqyrësi. (f. 57)	-u përgjigj mbikëqyrës i. (f. 411)
-E di, -tha konduktori (f. 29)	-E di, -tha konduktori. (f. 60)	-E di, -tha konduktori. (f. 401)	-E di, - tha mbikqyrësi. (f. 57)	-E di, - tha mbikëqyrës i. (f. 411)
Konduktori i tha emrin e vendit (f. 29)	Konduktori i tha emrin e vendit (f. 60)	Konduktori i tha emrin e vendit (f. 401)	Tjetri i tha emrin e vendit (f. 58)	Tjetri i tha emrin e ven-dit (f. 412)
-S'ju ka njeri faj, tha konduktori (f. 29)	-S'ju ka njeri faj, tha konduktori, (f. 61)	-S'ju ka njeri faj, -tha konduktori. (f. 401)	-S'ju ka njeri faj, - tha mbikqyrësi, (f. 58)	-S'ju ka njeri faj, - tha mbikëqyrës i, (f. 412)
Kaloi një konduktore e re (f. 30)	Kaloi një konduktore e re (f. 63)	Kaloi një konduktore e re. (f. 403)	Kaloi një nëpunëse e hekurudhës. (f. 60)	Kaloi një nëpunëse e hekurudhës. (f. 414)
-Posi,-tha konduktorja a. (f. 30)	-Posi,-tha konduktorja. (f. 63)	-Posi, -tha konduktorja. (f. 403)	-Posi, - tha nëpunësja. (f. 60)	-Posi, - tha nëpunësja. (f.414)
Konduktorja ngriti supet (f. 31)	Konduktorja ngriti supet (f. 63)	Konduktorja ngriti supet. (f. 403)	Konduktorja ngriti supet. (f. 60)	Nëpunësja ngriti supet. (f. 415)
Kaloi një vajzë konduktore (f. 46)	Kaloi një vajzë konduktore (f. 97)	Kaloi një vajzë konduktore (f. 415)	Kaloi një mbikqyrëse treni. (f. 70)	Kaloi një mbikëqyrës e treni. (f. 426)
	Vajza konduktore kaloi përsëri (f. 97)	Vajza konduktore kaloi përsëri. (f. 415)	Mbikqyrësja kaloi përsëri (f. 70)	Mbikëqyrësja kaloi përsëri (f. 426)

Konduktorj a pa orën. (f. 46)	Konduktorja pa orën. (f. 98)	Konduktorja pa orën. (f. 415)	Mbikqyrësja pa orën. (f. 70)	Mbikëqyrës ja pa orën (f. 426)
-------------------------------------	------------------------------------	-------------------------------------	------------------------------------	--------------------------------------

Tabela 6/gruri-misri

D 67	D 68	D 80	D 2000	D 2008
<p>1) [Mendimet për grurin 1] Sa të bëhet <u>gruri</u>, thoshte me vete, dhe do ta marr gjakun. <u>Gruri</u> rritej çdo ditë. <u>Gruri</u> po piqej... Sa ta korr grurin... (f. 18)</p>	<p>1) [mendimet për grurin 1] Kish mbjellë... një arë të madhe me <u>grurë</u>,... Ai pellg i vogël gjaku ... kishte më shumë vlerë se gjithë <u>gruri</u> i tij i florinjte. <u>Midis grurit</u> dhe gjakut ai kish zgjedhur <u>grurin</u>. ... Sa të bëhet <u>gruri</u> thoshte me vete. Sa të bëhet <u>gruri</u> dhe do ta marr gjakun. <u>Gruri</u> rritej çdo ditë. ...derisa <u>gruri</u> i gjaksit nuk ishte korrur (f. 35) Ah ky <u>gruri</u> sa ngadalë po piqej... <u>Gruri</u> po piquej çdo ditë... Ashtu siç ish i çuditshëm <u>ky</u></p>	<p>1) [mendimet për grurin 1] Kishte mbjellë... një arë të madhe me <u>grurë</u>... (f. 384) Sa të bëhet <u>gruri</u>, thoshte me vete . Sa të bëhet <u>gruri</u> dhe do ta marr hakun. <u>Gruri</u> rritej çdo ditë, ... Sa të korr <u>grurin</u>, ... Përderisa <u>gruri</u> i gjakësit nuk ishte korrur,... Ah, <u>ky gruri</u>, sa ngadalë po piqej. <u>Gruri</u> po piquej çdo ditë. Ky ishte një <u>grurë</u> i çuditshëm... Ai kishte korrur shumë <u>grurë</u> në jetën e tij,ashtu siç ishte i çuditshëm <u>ky</u></p>	<p>1) [mendimet për misrin 1] Kishte mbjellë një arë të madhe <u>me</u> <u>misër</u>, ... Sa të bëhet <u>misri</u> thoshte me vete. Sa të bëhet <u>gruri</u> dhe do ta marr gjakun. <u>Misri</u> rritej çdo ditë.... Sa të korr <u>misrin</u>, sa të mbledh kallëzat e fundit dhe pastaj... ...përderisa <u>misri</u> i gja- kësit nuk ishte korrur...</p>	<p>1) [mendimet për grurin 1] Tani ara e tij ishte mbjellë <u>me grurë</u>... Ai pellg i vogël gjaku,... kishte më vlerë se gjithë <u>gruri</u> i tij i florinjte. Sa të bëhet <u>gruri</u>, thoshtë me vete. Sa të bëhet <u>gruri</u> dhe do ta marr gjakun. <u>Gruri</u> rritej çdo ditë. (f. 395) Sa të korr <u>grurin</u>, sa të mbledh</p>

	<p><u>grurë</u> dhe kjo arë.... Ç'ishte kështu <u>ky grurë</u>? (f. 36)</p>	<p><u>grurë</u> dhe kjo arë ... Ç'ishte kështu <u>ky grurë</u>? (f. 385)</p>	<p>Ah, <u>ky misër</u>, sa ngadalë po piqej... <u>Misri</u> po pi-qej çdo ditë. Ky ishte <u>një misër</u> i çuditshëm, ... Ai kishte mbjellë dhe kishte korrur <u>shumë misër</u> në jetën e tij, po <u>misër</u> i tillë nuk i kishte qëlluar asnjëherë. (f. 44) ...ashtu siç ishte i çuditshëm <u>ky misër</u> dhe kjo arë, (f. 44) Ç'ishte kështu <u>ky misër</u>? (f. 45)</p>	<p>duajt e fundit dhe pastaj ... (f. 395-396) ...Përderis a <u>gruri</u> i gjakësit nuk ishte korrur... Ah, <u>ky gruri</u>, sa ngadalë po piqej.... <u>Gruri</u> po piqej çdo ditë. Ky ishte <u>një grurë</u> i çuditshëm ... Ai kishte mbjellë dhe kishte korrur <u>shumë grurë</u> në jetën e tij, po <u>grurë</u> i tillë nuk i kishte qëlluar asnjëherë. ...ashtu siç ishin të çuditshëm <u>ky grurë</u></p>
--	---	--	---	--

				dhe kjo arë. Ç' ishte kështu ky grurë? (f. 396)
2) [biseda me priftin] Folën për kohën për grurin për bagëtinë. (f. 18)	2) [biseda me priftin] Folën për kohën, për grurin, për bagëtinë.... Sa të korrej gruri, sa të mblidheshin duajt e fundit.(f. 37)	2) [biseda me priftin] Folën për kohën, për grurin, për bagëtinë. Sa të korrej gruri, sa të mblidheshin duajt e fundit. (f. 386)	2) [biseda me priftin] Folën për kohën, për <u>misrin</u> , për bagëtinë.... Sa të korrej drithi, sa të mblidheshin duajt e fundit. (f. 45)	2) [biseda me priftin] Folën për kohën, për grurin, për bagëtinë... . Sa të korrej gruri, sa të mblidheshin duajt e fundit. (f. 397)
3) [vrasja] U fsheh në grurë dhe priti... Kallzat e grurit e ngacmonin në vesh,...mënjanoi me tytë <u>disa kallza</u> , ... dhe shtiu. Flaka përzhiti <u>kallinjtë e grurit</u> . (f. 18-19)	3) [vrasja] U fsheh në grurë dhe priti,...Kallëza t e grurit e ngacmonin papushim në vesh, në qafë, në ballin e djersitur... (f. 37) Ai ngriti pushkën, mënjanoi me tytë <u>disa kallëza</u> . (ishte ndërhyrja e fundit e grurit). ... Flaka përzhiti <u>kallinjtë e</u>	3) [vrasja] U fsheh në grurë dhe priti... <u>Kallëza t e grurit e ngacmonin pa pushim në vesh, në qafë, në ballin e djersitur</u> . (f. 386) Ai ngriti pushkën, mënjanoi me tytë <u>disa kallëza</u> (ishte ndërhyrja e fundit e grurit).... Flaka përzhiti <u>kallinjtë e</u>	3) [vrasja] U fsheh në <u>misër</u> dhe priti.... <u>Kallinjtë e misrit</u> e ngacmonin pa pushim në vesh, në qafë, në ballin e djersitur... Ai ngriti pushkën, mënjanoi me tytë <u>disa kallëza</u> (ishte ndërhyrja e fundit e drithit).	3) [vrasja] U fsheh në grurë dhe priti... <u>Kallinjtë e grurit e ngacmoni pa pushim në vesh, në qafë, në ballin e djersitur</u> . Ai ngriti pushkën, mënjanoi me tytë <u>disa kallëza</u> (ishte ndërhyrja

	<u>grurit.</u> (f. 38)	<u>grurit.</u> (f. 387)	Flaka përzhiti <u>kallinjtë.</u> (f. 46)	e fundit e <u>grurit.</u> Flaka përzhiti <u>kallinjtë.</u> (f. 398)
4) [pas vrasjes] Ai po shkundëte <u>disa kallza gruri...</u> (f. 19)	4) [pas vrasjes] Ai po shkundte <u>disa kallëza gruri...</u> (f. 38)	4) [pas vrasjes] Ai po shkundte <u>disa kallëza gruri...</u> (f. 387)	4) [pas vrasjes] Ai po shkundte <u>disa kallëza...</u> (f. 46)	4) [pas vrasjes] Ai po shkundte <u>disa kallëza...</u> (f. 398)
5) [mendimet për grurin 2] pamja që larg a arës <u>me grurë.</u> <u>Gruri</u> u poq... si u kalb <u>gruri</u> në tokë (f. 19)	5) [mendimet për grurin 2] pamja e arës <u>me grurë.</u> <u>Gruri</u> u poq, (f. 38) ...si u kalb <u>gruri</u> në tokë, (f. 39)	5) [mendimet për grurin 2] pamja e arës <u>më grurë.</u> <u>Gruri</u> u poq. ...si u kalb <u>gruri</u> në tokë (f. 387)	5) [mendimet për misrin 2] <u>Misri</u> i poq, (f. 46) ...si u kalb <u>misri</u> në tokë... (f. 47)	5) [mendimet për grurin 2] pamja e arës <u>me grurë.</u> <u>Gruri</u> u poq,... ... si u kalb <u>gruri</u> në tokë (f. 399).

SUMMARY

VARIATIONS IN NOVEL *THE WEDDING* OF ISMAIL KADARE

The novel "Wedding" is a very important part of the work of the literary system of Ismail Kadare. In terms of the content and its topics, it is related to several other works of Kadare, such as "Broken April" which treats canon and revenge, and "The Three -Arched Bridge", which treats the motive of the sacrifice during building the three -arched bridge.

Seen from the formal perspective, "The Wedding" has a perfect structural organization that gives us ample opportunity to study philology.

The publication of this work has similarities with some other novels of the time: we are talking about those works published first in the literary journal "Nëndori", like the novel "Lumi i vdekur" ("Dead River") by Jakov Xoxe).

We take in consideration the different estimation about Kadare's work, as the whole and in particular about the novel "The wedding," made by the author himself and by several authors so far, such as Shaban Sinani, Arshi Pipa, Martin Camaj, Elio Miracco, Matteo Mandala.

There are five variants of the novel "The wedding" that we have taken in consideration here, as follows: *The first* variant, published in the Albanian journal "Nëndori" (Tirana, 1967); *the second* variant, published as a separate book, (Tirana, 1968); *the third* variant, included in the book "Gjakftohtësia" (Tirana, 1980); 4) *the fourth* variant, published by the publishing house FAYARD (Paris, 2000); *the fifth* variant, published by the publishing house "Onufri", Tiranë, 2008. We have tried to make a short description of the publication and also we tried to analyse the importance of the variants of the author, in order to determine the place of this book in the whole system work of Kadare and in Albanian literary system. The study of the variants helps us to see clearly the author's interference, his troubles, his efforts, his performance in writing, his creativity and his intellectual performance during the 60s of last century, to know better Kadare's literary system.

TABLE OF CONTENTS

REMZI PËRNASKA	Spiro Floqi - A distinguished Albanian linguist (1920-1983).....	5
EMIL LAË	New concepts and terms of Albanian syntax	13
MEHMET ÇELIKU	The place of Spiro Floqi Dialectologic questionnaire in the history of Albanian dialectology.....	25
BAHRI BECI	Spiro Floqi on Albanian syntax.....	35
LINDITË SEJDIU- RUGOVA	Spiro Floqi's contribution in linguistic critics	41
VALTER MEMISHA	Spiro Floqi about verbal valence.....	53
THOMA DHIMA	Rhema and contrast in the information structure of sentence.....	63
ENKELEIDA KAPIA	Issues of the sentences order in the syntactic studies of prof. Spiro Floqi.....	73
TEFË TOPALLI	Spiro Floqi and the minimal obligatory constituents of the sentence.....	89
ANILA KANANAJ	Subjective subordinate clause according to Floqi.....	101
ROZANA RUSHITI	Phrase, syntagma and their treatments in Albanian grammatology.....	109
ALBANA DEDA (NDOJA)	From <i>Etymological dictionary of Albanian V</i>	123
KOLEC TOPALLI	Words creations as a poetic process in the work of Lasgush Poradeci.....	143
THANAS FEKA	Archaic linguistic tosk features of Gjirokastra region compared to old geg linguistic features in Buzuku's <i>Missale</i>	149
MIMOZA KARAGJOZI- KORE	The motive for the creation of the universe: from Pjetër Bogdani and Nicolò Chetta to Pjetër Zarishi and father Gjergj Fishta.....	161
SHABAN SINANI	Variations in novel <i>The wedding of Ismail Kadare</i>	179
EDMOND ÇALI	The female figure in Vedat Kokona's poetic image.....	203
ERIOLA AGALLIU	CRITIQUES AND BIBLIOGRAPHY	
ANILA OMARI	Problems and perspectives in albanology - the situation of studies in a new book.....	217
EVALDA PACI	<i>Philological studies about italo-albanian romantic literature: a new result in albanological studies</i>	221
SHABAN SINANI	Matteo Mandalà, <i>Lekë Matranga: the</i>	

	<i>mankind, the time, the work (Lekë Matranga: njeriu, koha, vepra)</i> , Botimet Ombra GvG, Tiranë, 2013.....	225
PAVLI HAXHILLAZI	The publication of Thimi Mitko's original Italian - Greek - Albanian lexicographic manuscript.....	229
KOLEC TOPALLI	Anila Omari, <i>Albanian-Serbian linguistic relations (Marrëdhëniet gjuhësore shqiptaro-serbe)</i> , Botimet Albanologjike, Tiranë, 2012.....	237
RAMI MEMUSHAJ	Mehmet Çeliku, <i>Syntax of Albanian language, syntactic constituents -(Sintaksë e gjuhës shqipe, përbërësit sintaksorë)</i> , ILAR, Tiranë, 2012.....	241
ANILA KANANAJ	Thoma Dhima, <i>Temporal phrases with determinative-appositive subordinate clauses</i> , Qendra e Studimeve Albanologjike, Tiranë, 2013.....	247
INA ARAPI	Bahri Beci & Merita Bruçi, <i>Albanisch lernen in kurzer Zeit. Albanisch für Ausländer - Lehrbuch (Të mësojmë shpejt gjuhën shqipe. Metodë për mësimin e gjuhës shqipe nga të huajt)</i> , EDFA, Tirana, 2011.....	253
	SCIENTIFIC LIFE	
	In traces of albanology in Poland (Ina Arapi).....	259
	Scientific table: <i>The culture of the language in our medias - results and actual problems</i> (Adelina Çerpja).....	263
	International scientific conference: <i>Linguistic researches, II</i> , Tirana, 4 July 2013 (Engjëllushe Karaj).....	265

Shtypi u realizua në shtypshkronjën
"KRISTALINA-KH"
Rr: "Lord Bajron"
Tel.: 00355 4 2447 100
Cel.: 068 20 38 373, Cel.: 069 20 38 373
E-mail: kristalina-kh@hotmail.co.uk
Tiranë/Albania